



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 27.02.2025

Nr: 9

Ora: 12:00

VENDIM

PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 3, DATË 14.02.2025, DEPOZITUAR NGA QENDRA “QËNDRESA QYTETARE”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 27.02.2025, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ilijan	RUSMALI	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”

OBJEKT: Shfuqizimi i Vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

BAZË LIGJORE: Nenet 92, 124/1 dhe 171 pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Rrethanat e çështjes:

1. Organizata Qendra “Qëndresa Qytetare”, më datë 20.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nëpërmjet adresës së postës elektronike *e-mail*, kërkesën për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë.
2. Në këtë kërkesë, organizata Qendra “Qëndresa Qytetare” parashtron se në datë 20.02.2025, janë njoftuar përmes platformave të komunikimit elektronik dhe mediave të ndryshme se, në të njëjtën datë, në ora 16:30, Kryeministri do të zhvillojë një takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë. Të dhënat e publikuara tregojnë se, në këtë takim do të marrë pjesë në mënyrë të organizuar dhe të detyruar e gjithë administrata e Bashkisë Tiranë dhe secila prej drejtorive apo institucioneve në varësi të saj, do të mbajë përgjegjësi për vërtetësinë e numrit të stafit të pranishëm. Në kushtet kur veprimtaria e cituar më sipër, sipas të dhënave që dispononte deri në atë kohë kërkuesi, prezantohet si një veprimtari me karakter publik, që organizohet nga Kryeministri dhe që zhvillohet në periudhën katër mujore të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, është e hapur për mediat dhe publikun, pra punonjësit e Bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, ajo përfshihet në kuptimin e “veprimtarive publike”, në referim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Për rrjedhojë, kjo veprimtari duhet të ishte raportuar nga ana e Kryeministrit, në përputhje me nenin 92 të Kodit Zgjedhor. Nga verifikimi që kërkuesi ka kryer në ndërfaqen elektronike të raportimeve NRI, i ka rezultuar se kjo veprimtari nuk është raportuar nga ana e organit përgjegjës. Përkundrazi, po sipas kërkuesit, Kryeministria ka raportuar se të vetmet aktivitete publike që do të zhvillohen nga ana e institucionit në datën 20.02.2025, janë “*Inaugurimi i Spitalit të Pediatriisë në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë “Nënë Tereza”*” dhe *Ceremonia e Hapjes së “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”* (Veprimtaritë e raportuara për t’u zhvilluar më datë 20.02.2025).
3. Nga hetimi administrativ rezulton se në datë 14.02.2025, personi përgjegjës për raportimet në institucionin e Kryeministrit, ka raportuar në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor, dy veprimtari me tematika si vijon:
 - a. “*Inaugurimi i Spitalit të Pediatriisë në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë “Nënë Tereza”*” - Aktiviteti do të zhvillohet në datë 20.02.2025, ora 10:00. Vendi i zhvillimit të veprimtarisë: Njësia administrative nr. 3. Në këtë aktivitet është ftuar të marrë pjesë edhe Kryeministri i vendit, Z. Edi Rama. Zhvillimi këtij aktiviteti është raportuar në datë 14.2.2025.
 - b. *Ceremonia e Hapjes “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”* - Në këtë ceremoni janë ftuar të marrin pjesë autoritete vendase dhe të huaj, ceremoni në të cilën do të jetë i pranishëm si i ftuar edhe Kryeministri i vendit Z. Edi Rama. Veprimtaria është raportuar në datë 14.02.2025 për t’u zhvilluar në datë 20.02.2025, ora 16:00, Vendi i zhvillimit të veprimtarisë: TKOB, njësia administrative nr. 2.
4. Në vijim, nëpërmjet postës elektronike, personi përgjegjës për raportimet në institucionin e Kryeministrit, në datë 19.2.2025 (një ditë përpara zhvillimit të aktivitetit), ka njoftuar për veprimtarinë e parë se aktiviteti “*Inaugurimi i Spitalit të Pediatriisë*” është shtyrë për në datën 21 shkurt, në ora 09:00. Gjithashtu, po në datë 19.02.2025, në lidhje me veprimtarinë e dytë

“Ceremonia e Hapjes “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025””, ka njoftuar se “Për shkak të afërsisë së eventit është e pamundur ndryshimi në sistem i vendit ku do organizohet aktiviteti. Nga TKOB, vendndodhja e zhvillimit do të jetë Sheshi “Skënderbej”, në orën 16:30, po në njësinë administrative nr. 2”.

5. Nga sa më sipër, rezulton se vetëm këto dy veprimtari janë raportuar nga institucioni i Kryeministrisë në ndërfaqen elektronike të raportimeve NRI për datën 20.02.2025 dhe më tej njoftimi për ndryshimin e kohës dhe vendit të organizimit të tyre është kryer nëpërmjet postës elektronike.
6. Referuar kërkesës së ankuesit “Qëndresa Qytetare”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në datën 20.02.2025, në ora 16:00, ka trajtuar tematikat e veprimtarive të raportuara nga institucioni i Kryeministrisë dhe në përfundim ka arritur në rezultatin se ato nuk përfshihen në fushën e veprimtarive të ndaluara, ndalime këto të parashikuara nga neni 92 i Kodit Zgjedhor, si dhe Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, i ndryshuar. Sipas KShZ, këto veprimtari janë raportuar në përputhje me parashikimet ligjore më sipër, e për rrjedhojë, nuk ka vend për ndalimin e ndonjëres prej këtyre dy veprimtarive.
7. Kundër vendimit nr. 129, datë 20.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është paraqitur ankim për shfuqizimin e tij nga Qendra “Qëndresa Qytetare”, në referim të neneve 92, 124/1 dhe 171 pika 1 të K.Zgjedhor si dhe neneve 3 dhe 10 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.
8. Sipas rregullores së punës, KAS-i caktoi me short anëtarin Ledio Braho si relator të çështjes dhe në datën 25.02.2025 zhvilloi seancën paraprake me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të ankuesit z. Dhimitër Zguro, për Qëndresën Qytetare dhe zj. Madalena Koja me detyrë jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri. Në përfundim të seancës paraprake, u vendos që të pranohej pjesërisht për shqyrtim kërkesa ankimore, vetëm sa i përket pikës 1 të saj sipas të cilës kërkohej shfuqizimi i vendimit nr. 129, datë 20.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
9. Në seancën e shqyrtimit administrativ të datës 27.02.2025 ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuesi i palës ankimuese, z. Dhimitër Zguro dhe në cilësinë e përfaqësuesit të Kryeministrisë, zj. Madalena Koja. Po ashtu, referuar aktivitetit të denoncuar nga ankuesi, është njoftuar si palë e interesuar edhe Bashkia Tiranë, e cila pavarësisht dijenisë, nuk ishte e pranishme si në seancën paraprake ashtu edhe në atë të shqyrtimit administrativ.
10. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 3, datë 21.02.2025, depozituar nga Qendra “Qëndresa Qytetare”;
 - Vendimin nr. 129, datë 20.02.2025 “Për shqyrtimin e kërkesës së datës 20.02.2025, të Organizatës Qendra “Qëndresa Qytetare”;
 - Raportimin e Kryeministrisë në ndërfaqen e dedikuar për raportim me tematikë “Inaugurimi i Spitalit të Pediatriisë në Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’;

- Raportimin e Kryeministrisë në ndërfaqen e dedikuar për raportim me tematikë “Tirana është shpallur “Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”;
- Korrespondencën nëpërmjet postës elektronike.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare të palëve,

KAS-i konstatoi:

11. Si fillim, nga vetë raportimi i personit përgjegjës në Kryeministri, rezulton se në aktivitetin Ceremonia e Hapjes “*Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025*”, kryeministri ishte në cilësinë e personit të ftuar dhe jo organizator apo bashkorganizator. Pika 3 e nenit 5 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 parashikon se “*raportimi bëhet për veprimtari të cilat organizohen, ose bashkorganizohen nga institucioni publik raportues. Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë*”. Sipas raportimit, veprimtaria organizohej nga Bashkia Tiranë dhe Kryeministri ishte personalitet i ftuar për të marrë pjesë në ceremoni. Ndaj, personi përgjegjës për raportimet në Kryeministri nuk duhet të kishte raportuar për veprimtarinë Ceremonia e Hapjes “*Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025*”.
12. Gjithashtu, është me vend për t’u theksuar që personi përgjegjës për raportimet në Kryeministri nuk mund të modifikonte të dhënat e raportimit, siç është vepruar me aktivitetin e sipërcituar. Të dhënat e raportimit përfshijnë datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë, qarkun, bashkinë, adresën ku ajo zhvillohet, llojin e saj, qëllimin dhe tematikën e veprimtarisë, emër mbiemër të personave pjesëmarrës të cilët përfaqësojnë nivelin më të lartë hierarkik shtetëror në aktivitetin përkatës, institucionin të cilit i përkasin, emër mbiemër të folësve të mundshëm dhe pozicionin e tyre, me pjesëmarrje të medias ose jo, pasqyruar në rrjete sociale, median *online*, ose jo (pika 5 e nenit 5 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020). Personi përgjegjës ka modifikuar orën dhe adresën e zhvillimit të veprimtarisë. Modifikimin mund t’a bëjë vetëm personi përgjegjës i institucionit organizator, por edhe ky i fundit nuk lejohet që të bëjë modifikim “*në periudhën 5 (pesë) ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit deri në datën e zhvillimit të tij*” (pika 6 e nenit 5 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020). Modifikimet e bëra përtej këtij afati nuk mund të merren në konsideratë, sepse ky afat është prekluziv.

13. Ankuesi Qendra “Qëndresa Qytetare”, nëpërmjet komunikimit elektronik, ka depozituar në datë 20.2.2025 në KQZ “Kërkesë urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike”. Kërkesa për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë është depozituar për shkak se “rezulton se kjo veprimtari nuk është raportuar nga ana e organit përgjegjës”. Ankuesi nuk mund të paraqiste një kërkesë të tillë, për një shkak të tillë, për dy arsye të rëndësishme: Së pari, kërkesa për ndalimin e veprimtarisë mund të paraqitet vetëm për veprimtari të raportuara dhe jo, siç pretendohet, për veprimtari të paraportuara; dhe së dyti KShZ ka të drejtë të ndalojë zhvillimin e një veprimtarie publike të raportuar, në rast se del në konkluzionin se kjo veprimtari përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të Kodit Zgjedhor dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Për një veprimtari publike të paraportuar, rruga ligjore që ankuesi duhet të ndiqte mund të ishte vetëm ajo e denoncimit për mosraportim, e shoqëruar me kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ që zbatohet për mosraportimin, referuar nenit 10 pika 1 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 ose në rast se nga hetimi administrativ do të rezultonte se titullari i institucionit ka penguar raportimin, atëherë do të ishim në kushtet e pikës 2 të po këtij neni.
14. Ndalimi nga KQZ-ja bëhet vetëm në rrugë burokratike, duke vendosur në faqen përkatëse të portalit të raportimeve shënimin “Ndaluar nga KQZ” (prandaj ndalohen vetëm veprimtaritë e raportuara në ndërfaqen e raportimeve). Ky shënim nuk është akt administrativ me ekzekutim të detyrueshëm. Në dispozicion të KQZ-së nuk funksionon ndonjë strukturë policore elektorale që të zbatojë urdhrin e ndalimit. Subjekti që kryen veprimtarinë duhet të marrë vetë masa për moszhvillimin e saj dhe transmetuesit radio-televizivë duhet të marrin vetë masa për mostransmetimin apo pasqyrimin e saj në rubrikat e lajmeve apo në rubrikat që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Përndryshe ndaj tyre vendosen sanksione.
15. Arsyeja e dytë që e bën të pambështetur në ligj kërkesën e ankuesit drejtuar Komisionerit qëndron në faktin se vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 lejon paraqitjen e kërkesave nga palët e treta me objekt ndalimin e veprimtarive të raportuara, “jo më vonë se 3 (tre) ditë nga data e planifikuar e mbajtjes së tyre” (pika 3 e nenit 9). Kërkesat e paraqitura përtej këtij afati nuk mund të merren në konsideratë, sepse edhe ky afat është prekluziv. Nëse e arsyetojmë *a contrario* këtë dispozitë, arrijmë në përfundimin se nuk mund të kërkohet ndalimi i një veprimtarie të paraportuar.

16. Komisioneri ka marrë në shqyrtim një kërkesë, të cilën nuk mund ta merrte në shqyrtim dhe, lidhur me të, ka dhënë një vendim, të cilin nuk mund ta jepte, për shkak se ishte i pambështetur në fakt dhe në ligj.
17. Komisioneri nuk mund të merrte në konsideratë si “raportim” shënimin në ndërfaqen e raportimeve të kryer nga një institucion, i cili nuk bart detyrimin për raportim, nuk mund të merrte në konsideratë modifikimin e të dhënave të kësaj veprimtarie për të njëjtin shkak, por edhe për shkak se modifikimi ishte paraqitur përtej afatit që lejon ligji, nuk mund të merrte në konsideratë “kërkesën urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike”, formalisht sepse ishte paraqitur jashtë afatit, ndërsa në thelb për shkak se ishte kontradiktore dhe e pambështetur në ligj. Pavarësisht nga kjo, Komisioneri ka zhvilluar procedurë shqyrtimi dhe ka dalë në konkluzionin se veprimtaria ishte raportuar sipas ligjit dhe se nuk kishte vend për të urdhëruar ndalimin e saj, pavarësisht faktit se tjetër aktiviteti i referohej ankuesi e tjetër KShZ në vendimmarrjen objekt të shqyrtimit administrativ.
18. Veprimtaria e organizuar në sheshin “Skënderbej”, në ora 16:30 të datës 20.02.2025, me pjesëmarrjen e posaçme të Kryeministrit është dukshëm një veprimtari e ndryshme nga veprimtaria e titulluar “*Ceremonia e Hapjes “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”*”. Sikurse rezulton nga provat veprimtaria ishte “*takim i Kryeministrit me punonjësit e bashkisë Tiranë*”. Analiza e fjalës së mbajtur nxjerr në pah se në thelb qëllimi ishte që stafi i bashkisë të mbante lart mobilizimin në kushtet kur Kryetari i Bashkisë ndodhej në pamundësi drejtimi, për shkaqe të pavarura prej tij, si dhe të forcohej bashkëpunimi me Qeverinë dhe energjitë të përqendroheshin në plotësimin me sukses të detyrave të posaçme që rridhnin nga eventet me rëndësi ndërkombëtare që pret kryeqyteti pas zgjedhjeve. Tematika dhe qëllimi janë krejt të ndryshme nga tematika dhe qëllimi i veprimtarisë inaugurale të raportuar “*Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025*”.
19. Veprimtaria kishte të ndryshme qëllimin dhe tematikën, orën dhe vendin e organizimit, rrethin e pjesëmarrësve dhe rrethin e të ftuarve. I njëjtë ishte institucioni organizator dhe folësi kryesor. Veprimtaria objekt i “kërkesës urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike”, siç rezulton edhe pas zhvillimit të saj, ishte një aktivitet me punonjësit e bashkisë Tiranë. Ky fakt konfirmohet edhe

nga vetë faqja *web*¹ e Kryeministrit sipas të cilës rezultoi se “Kryeministri Edi Rama zhvilloi sot një takim me punonjësit e Bashkisë së Tiranës në sheshin “Skënderbej”, gjatë të cilit u transmetua edhe një dokumentar mbi transformimin e Tiranës ndër vite. “Unë jam këtu për t’u thënë të gjithëve ju, se deri kur çështja e Kryetarit të Bashkisë të marrë drejtim, në një mënyrë apo një tjetër, vëmendja ime për Tiranën, për bashkinë, për problemet dhe punët tuaja do të jetë e pandërprerë” – u shpreh kryeministri Rama në fjalën e tij”. Të gjitha të dhënat e ndryshme janë përcaktuese për ta cilësuar veprimtarinë të ndryshme dhe jo identike me veprimtarinë e raportuar si “Ceremonia e Hapjes “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025””. Fakti është se kjo veprimtari është veprimtari e paraportuar.

20. Ankuesi ka vënë në lëvizje procesin administrativ, me qëllimin për të ndaluar një veprimtari publike, me arsyetimin se kjo veprimtari ishte e paraportuar. Një kërkesë e tillë duhet të ishte rrëzuar nga Komisioneri për shkaqet e shtjelluara në këtë arsyetim vendimi ose në alternativë duhet të ishte trajtuar në kuptim të faktit nëse aktiviteti i denoncuar nga Qëndresa Qytetare ishte një aktivitet i raportuar apo jo dhe nëse do i rezultonte i paraportuar të vijonte hetimin administrativ në këtë linjë. Në fakt, kërkesa është rrëzuar mbështetur në një arsyetim të pajustificuar ligjërisht dhe të pambështetur në fakte, pasi pavarësisht kërkesës së ankuesit, KShZ ka trajtuar një aktivitet tjetër të raportuar nëse ai ishte në kushtet për t’u ndaluar apo jo. Ankuesi ndoqi, në vijim, procedurën ankimore, pavarësisht se kryerja e ankimit *post factum* nuk mund të plotësonte më kërkesën e tij. Pavarësisht nga ky fakt, KAS-i ka detyrimin që të vendosë për objektin e kërkesës, të përcaktojë nëse vendimi i Komisionerit është i mbështetur në fakte dhe në ligj dhe, mbi këtë bazë, të vendosë lënien në fuqi ose shfuqizimin e tij. Duke qenë se KAS kreu hetime administrative shtesë në raport me hetimin e KShZ në lidhje me aktivitetin e kërkuar/denoncuar nga ankuesi, arriti në përfundimin se aktiviteti ku pjesëmarrës ishte Kryeministri Edi Rama në datën 20.02.2025, ora 16:30, në sheshin “Skënderbej”, është një aktivitet i paraportuar. Ndaj, për sa më sipër, KAS gjykon se rruga e vetme e drejtë është shfuqizimi i vendimit të Komisionerit, sepse kështu palët kthehen në pozicionet juridike fillestare dhe kanë mundësinë që të orientojnë qëndrimin e tyre, këtë radhë nga pozicione të ligjshme si dhe tashmë është hetimi administrativ pranë KShZ, ai që duhet të përcaktojë se cili ishte organi publik që duhet të raportonte këtë aktivitet dhe të përcaktojë dhe sanksionin përkatës pasi të

¹ <https://www.kryeministria.al/newsroom/fjala-e-kryeministrit-rama-ne-takimin-me-punonjesit-e-bashkise-se-tiranes/>

individualizojë shkeljen administrative të konsumuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21 pika 1 shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative“, të ndryshuar” mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tirane, brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.

Njoftuar palëve të pranishme me shpalljen.

U shpall sot, më datë 27.02.2025.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ilijan	RUSMALI	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar